



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration

Për :	Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës së Pejës Rexhep Kurtbogaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së, Jeton Qela, U.d Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani, U.d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 05.01.2024 Nr.020-496/5
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Gafurr Sllamniku, Zyrtar i lartë për Monitorimin e Komunave 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit	
Lloji i aktit:	Vendim	

**I nderuar Kryetar,**

**I nderuara Kryesues,**

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr: 67/2023 për shfuqizimin e Vendimit Nr. 20/2021 i datës 31.05.2023

I miratuar më datë: 28.12.2023

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 28.12.2023

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

## Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Pejës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.12.2023, ka miratuar Vendim Nr. 67/2023 për shfuqizimin e Vendimit Nr. 20/2021 i datës 31.05.2023

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Pejës, është bazuar në nenin 12 dhe nenin 82.2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, i miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Pejës me datë 28.12.2023.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

\_\_\_\_\_  
E. S. S.

\_\_\_\_\_  
E. S. S.



## Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za :	Gazmend Muhaxher, gradonačelnik opštine Peć Rexhep Kurbogaj, predsedavajuća Skupštine opštine Peć
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Jeton Qela, zamenik generalnog sekretara MALS-a
Od:	Besim Murtezani, zamenik rukovodioca Pravnog odeljenja i i monitorisanje opština, MALS Dana, 05.01.2024 Br.020-496/5
Odgovorni službenici:	Xhevat Tafa, Rukovodilac Odseka za monitorisanje opština Gafurr Sllamniku, viša službenica za monitorisanje opština
1. Službenik-ca za utvrđivanje pravne procene:	
2. Službenik-ca za izradu pravne procene	
Predmet:	Zahtev za razmatranje akta
Vrsta akata:	Odluke

Poštovani gradonačelnice,

Poštovana predsedavajuća,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosovo br. 10/2019 o administrativnom razmatranju akata opština, kao i Uredbom br. 06/2021 o izmeni i dopuni Uredbe (VRK) br. 10/2019, o administrativnom razmatranju akata opština, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva utvrđenih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023 o oblastima i administrativnim odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi sledeći opštinski akt:

Odluku br. 67/2023 o poništavanju Odluke br. 20/2021 od 31.05.2021

Usvojena dana, 28.12.2023

Preložena na razmatranje u MALS-u dana 28.12.2023.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, ocenjuje da je akt opštine u proceduralnom aspektu u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi.

## Obrazloženje

Skupština opštine Peć, na svom sastanku održanom 28.12.2023. godine, usvojila je Odluku br. 67/2023 o poništavanju Odluke br. 20/2021 od 31.05.2021. godine.

MALS zaključuje da je odluka koju je donela Skupština opštine Peć zasnovana na članu 12. i članu 82.2 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi, usvojena na sednici Skupštine opštine Peć 28.12.2023. godine.

Ministarstvo za lokalnu samoupravu ostaje na raspolaganju opštini radi bilo kakvog daljeg pojašnjenja u vezi sa ovom ocenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEÇ

Kryesia e Komunitetit të Pejë, Komiteti i Administratës Lokale të Pejë, Komiteti i Administratës Lokale të Pejë		
Ministria e Administratës të Përbashkët, Komiteti i Administratës Lokale të Pejë, Komiteti i Administratës Lokale të Pejë		
Komiteti i Administratës Lokale të Pejë, Komiteti i Administratës Lokale të Pejë		
Data	28-12-2023	
Orari		
Qëllimi		
Shprehja e përgjigjes	By / Komiteti	Mirësi
	41	020-496/15

**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS**

**I. Numër: 463-01/116939, dt. 28. Dhjetor 2023.**

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12. 2. pika (d) të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28.datë: 04. Qershor 2008”), nenit 53 paragrafi I i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 20/21 Qershor 2016”) dhe nenit 20 paragrafi I pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, 01.Numër: 09 – 8103 dt.30. Shtator 2020, bazuar në vlerësim të ligjshmerisë së MAPL-së, Nr.020-496/2, dt.25.06.2021 për Vendimin Nr.20/2021 të dt. 31.05.2021, në rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 28. Dhjetor 2023, merr:

**V E N D I M**

**Nr. 67/2023**

**Mbi shfuqizimin e Vendimit Nr. 20/2021 të datës 31.05.2021 të Kuvendit të Komunës së Pejës**

- I. **SHFUQIZOHET** Vendimi Nr. 20-2021 mbi miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbim të pronës së paluajtëshme komunale me pronen private për rregullimin dhe formimin e rrugës në fsh. Zahaq të komunës së Pejës, me nr. të prot. 463/01-46215, dt. 31.05.2021.
- II. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi Nr. 20/2021, me nr. të prot. 463/01-46215, i datës 31 Maj 2021, dhe nuk prodhon efekt juridik.
- III. Për Zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Pejës në bashkëpunim me DCPJ-së të Komunës së Pejës.
- IV. Ky vendim hynë në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në Web Faqen zyrtare të Komunës.



Vendimi ti dërgohet:  
1x1 MAPL-së,  
1x1 Kryetarit të Komunës,  
1x1 DCPJ,  
1x1 Arkiv.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS  
MUNICIPALITY OF PEJA  
OPŠTINA PEÇ



ZYRA E KRYETARIT  
MAYOR OFFICE  
URED PRECEDNIKA

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008, nenit 53 paragrafi 1 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative ( Ligji nr.05/L-031 i Republikës së Kosovës ) dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokolli L.nr. 01-016/01-413431/2020 i datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës së Pejës, merr këtë:

### K o n k l u z i o n

I propozohet Komitetit për Politik dhe Financa ta shqyrton dhe t'ia rekomandon Kuvendit Komunal në Pejë për shfuqizimin e Vendimit nr. 20/2021 dt. 31.05.2021 mbi miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për Këmbimin e Pronës Komunale me Pronën private, bazuar në vlerësimin e ligjshmërisë së MAPL-së nr. 020-496/2 dt.25.06.2021.

Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Drejtorati për Çështje Pronësore Juridike.

Konkluzioni i dërgohet:

- Drejtoratit për Çështje Pronësore Juridike,
- Sekretarisë së Kuvendit Komunal në Pejë,
- Anëtarëve të Komitetit për Politik dhe Financa dhe
- Arhivës

KOMUNA E PEJËS


L.nr. 463.01/11.10.2023 2023  
Pejë, 08 dhjetor 2023




Gazmend Muhaxheri  
Kryetar i Komunës



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

<i>Datë/Nr.</i>	08.12.2023 /Nr.15-463-LP-02/2021
<i>Për:</i>	<i>Rexhep Kurthogaj, Kryesues i Kuvendit Komunal të Pejës</i>
<i>CC:</i>	<i>-Të gjithë anëtarëve të Kuvendit Komunal të Pejës -Komitetit për Politik dhe Financa -Drejtorisë për Çështje Pronësoro –Juridike</i>
<i>Nga:</i>	<i>Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës së Pejës</i> 
<i>Lënda:</i>	<i>Propozim për Shfuqizimin e Vendimit nr.20/2021 dt.31.05.2021 KK Pejë mbi miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për Këmbimin e Pronës Komunale me Pronën private për rregullimin dhe formimin e rruges në fshatin Zahaq.</i>



Te nderuar,

Duke u bazuar në nenin 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008, nenit 53 par.1 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Ligji nr.05/L-031 i Republikës së Kosovës), Kryetari i Komunës së Pejës parashtron Kuvendit Komunal Pejë, këtë:

### PROPOZIM

**Shfuqizimin e Vendimit nr.20/2021 dt.31.05.2021 mbi miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për Këmbimin e Pronës Komunale me Pronën private për rregullimin dhe formimin e rruges në fshatin Zahaq.**

Me Vendimin 21/2021 dt.31.05.2023 mbi miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për Këmbimin e Pronës Komunale me Pronën private për rregullimin dhe formimin e rruges në fshatin Zahaq paraprakisht ky këmbim dhe prona nuk janë shpallur Interes Publik për rregullimin dhe formimin e rruges në fshatin Zahaq dhe nuk është në pajtim me dispozita ligjore bazuar në vlerësim të ligjshmerisë së MAPL-së nr. 020-496/2 dt.25.06.2021.

Me respekt,



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEÇ

## KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES

I.Numër: \_\_\_\_\_,

Në bazë të nenit 11 dhe 12 shkronja (d) të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008, nenit 53 par.1 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Ligji nr.05/L-031 i Republikës së Kosovës), , nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431.dt.30 shtator 2020, Kuvendi Komunal në Pejë, në takim të mbajtur me datë: \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_ 2023, bazuar në vlerësim të ligjshmerisë së MAPL-së nr. 020-496/2 dt.25.06.2021 për Vendimin nr.20/2021 dt.31.05.2021 mori këtë:

### PROPOZIM VENDIM

Nr. \_\_\_\_/2023

Mbi Shfuqizimin e Vendimit nr.20/2021 dt.31.05.2021 KK Pejë

- I. SHFUQIZOHET - Vendimi nr.21/2021 datë 31.05.2021 i KK Pejë mbi miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për Këmbimin e Pronës Komunale me Pronën private për rregullimin dhe formimin e rrugës në fshatin Zahaq.
- II. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi nr.21/2021 dt.31.05.2023 KK Pejë mbi miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunes për Këmbimin e Pronës Komunale me Pronën private për rregullimin dhe formimin e rrugës në fshatin Zahaq dhe nuk prodhon efekt juridik.
- III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësoro -Juridike.
- IV. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në ëeb faqen e Komunës së Pejës.

KRYESUESI I KUVENDIT

REXHEP KURBOGAJ





KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEË

KUVENDI KOMUNAL PEJË

I. Numër: 463/01-46218, datë: 31.05.2021.

Në bazë të dispozitave të nenit 11 dhe 12 të Ligjit nr.03/L-040 për vetqeverisje lokale të Republikës së Kosovës dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit mbi dhënjën në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës Komunale Ligji nr.06/L-092, si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Pejës, 01/2020 dt.30.09.2020, pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës për miratim paraprak për këmbimin e pronës së paluajtëshme komunale me pronën private të pronarit privat Shkelzen Kelmendi nga Fsh Zahaq Komuna e Pejë, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal në seancën e mbajtur me dt. 31. Maj 2021, muar:

V E N D I M

№.24/2021

MBI MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR KËMBIM TË PRONËS SË PALUAJTËSHME KOMUNALE ME PRONËN PRIVATE PËR RREGULLIMIN DHE FORMIMIN E RRUGËS NË FSHATIN ZAHAQ KOMUNA E PEJËS

I. MIRATOHET propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtëshme komunale me pronën e personit fizik, e më qellim të rregullimit dhe formimit të rrugës në fshatin Zahaq Komuna e Pejës.

II. Për realizimin e këtij këmbimi sipas këtij Vendimi është propozuar që të zhvillohen procedurat e nevojshme ligjore për këmbimin e pronës private dhe pronës së Komunës për interes publik në pjesën e hapësirës ndërtimore për shfrytëzimin racional të tokës e cila është objekt i këmbimit në mes të Komunës dhe pronarit privat e cila gjëndet në ngastren kadastrale 119/3 një pjesë prej 420 m<sup>2</sup> pronë shoqërore e KK Pejë, ZK Zahaq i janë propozuar për një pjesë prej 420 m<sup>2</sup> në ngastren 138/4 ZK Zahaq, të pronarit privat Shkelzen Kelmendi nga Zahaqi Komuna e Pejës, në rrepe vlersimin ligjor do ta bëjë Zyra për vlersimin e paluajtëshmorisë në kuadër të Ministrisë për Financa.

III. Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, Komuna në afat prej pesë ditëve e paraqet kërkesën për vlersimin e pronave të paluajtëshme sipas pikës II të këtij vendimi Zyrës për Vlersimin e pronës së Paluajtëshme pranë Departamentit të Tatimit në Pranë në kuadër të Ministrisë së Financave.


IV. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7 (shtat) dit pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Vendimi t'i dërgohet:

1x1. MPL.

1x1. Kryetarit të komunës.

1x1. Arkivë.





# Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës së Pejës Islam Husaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave	Datë: 18.06.2021 Nr. 020-496
Zyrtarët përgjegjës		
1. Zytari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zytari hartues i vlerësimit ligjor	Sanije Dërguti, Zytare e lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të komunës së Pejës	
Lloji i aktit:	<input type="checkbox"/> Vendim i Kuvendit të Komunës	

I/e nderuar Kryetar,

I/e nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimin Nr.20/2021 mbi miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbim të pronës së paluajtshme komunale me pronën private për rregullimin dhe formimin e rrugës në fshatin Zahaq komuna e Pejës

Miraturar më datë: 31.05.2021

I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 02.06.2021

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendimin Nr.20/2021 mbi miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbim të pronës së paluajtshme komunale me pronën private për rregullimin dhe formimin e rrugës në fshatin Zahaq komuna e Pejës	<p>Vendimin Nr.20/2021 mbi miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbim të pronës së paluajtshme komunale me pronën private për rregullimin dhe formimin e rrugës në fshatin Zahaq komuna e Pejës, nuk është në pajtim me Ligjin NR.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe me Rregulloren (QRK) Nr. 09 /2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.</p> <p>Sipas Nenit 24 të Ligjin NR.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, pika 4 e këtij neni thekson se "për realizimin e këmbimit të pronës", prona e cila këmbëhet duhet të jetë e shpallur paraprakisht nga Kuvendi i Komunës si pronë me interes publik përveç nëse prona e tillë arsyetohet me Planin Zhvillimor të Komunës.</p> <p>Komuna e Pejës nuk ka miratuar vendim paraprak për pronën në fjalë dhe nuk na ka njoftuar se a është e rregulluar me Planin Zhvillimor Komunal.</p>

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Bashkëngjitur e gjeni shkresën njoftuese Nr.013-534, të datës 18.06.2021 nga MAPL-ja